

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Mr.sc. Rafet Haxhaj kryetar dhe Gani Avdiu e Fejzullah Rexhepi anëtarë, në çështjen kontestimore të paditësit H.I. nga Istogu, kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës – PTK me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të diferencës së pagës, duke vendosur sipas ankesës së paditurit, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë- Dega në Istog, C.nr. 105/012 i dt. 20.09.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 27.04.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e pjesërishëm të ankesës së të paditurit PRISHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë- Dega në Istog, C.nr. 105/12 i dt. 20.09.2013 në pjesën si në pikën I. të dispozitivit me të cilën “DETYROHET e paditura që paditësit ti paguaj ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe trustit në mes të gradës 7 dhe 8, për çdo muaj duke filluar nga data 01.02.2012 e tutje me kamatë 4%, duke filluar nga data 01.02.2013 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit”, dhe për këtë pjesë çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, në pjesën si në pikën I. të dispozitivit të të njëjtit aktgjykim me të cilin është aprovuar kërkesëpadia e paditësit dhe është bërë anulimi i aktvendimit të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Nr. 01-1040-12393/2012, për këtë pjesë ankesa e të paditurës refuzohet si e pa themeltë, ndërsa aktgjykimi i atakuar VËRTETOHET, ndërsa në pikën II. të dispozitivit aktgjykimi C.nr. 105/012 i datës 20.09.2013 mbetet i pa shqyrtuar.

A r s y e t i m

Rrethanat e çështjes:

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, është aprovuar në tërësi kërkesëpadia e paditësit H.I. nga Istogu, është anuluar aktvendimi i të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Nr. 01-1040-12393/2012, i datës 07.03.2012 dhe është detyruar e paditura që paditësit ti paguaj ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe trustit në mes të gradës 7 dhe 8, për çdo muaj duke filluar nga data 01.02.2012 e tutje me kamatë 4%, duke filluar nga data 01.02.2013 e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Secila palë i bart shpenzimet e veta.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës

së dytë ta aprovojë ankesën e të paditurës dhe të ndryshoj aktgjykimin e atakuar me ankesë ashtu që të refuzohet si e pa themeltë kërkesëpadia e paditësit, apo aktgjykimi i atakuar me ankesë të prishet dhe çështja të kthehet në rigjykim, në gjykatën e shkallës së parë.

Në këtë çështje nuk është parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK, gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me padi ka kërkuar anulimin e vendimit të të paditurës dhe kompensimin e diferencës së pagës, ndryshimin e bonusit dhe trustit në mes të gradës 7 dhe 8, duke filluar nga data 01.02.2012 e në vazhdim deri në pagesën definitive.

E paditura e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se vendimi mbi uljen e gradave është i drejtë dhe i ligjshëm dhe në harmoni me autorizimet dhe kompetencat e punëdhënësit si dhe më vendimin e aksionarit Qeverisja e Republikës së Kosovës për reduktimin e shpenzimeve për personelin e të paditurës.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në kontratën e punë të lidhur në mes të punëdhënësit (të paditurës) dhe punëmarrësit (paditësit) të datës 20.10.2011, në bazë të së cilës paditëses i është caktuar grada 8 si pagë bazë për punën e kryer, po ashtu aktgjykimin e ka bazuar në dispozitat e nenit 11 të Ligjit të Punës si dhe nenit 186 dhe 277 të LMD-së.

Baza ligjore:

Neni 194 i LPK: “Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 , pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji”.

Neni 195.1 i LPK: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur “.

Neni 195.1 i LPK: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:c) ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta kthej çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë”.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata e Apelit nuk mund ta pranon qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në pjesën detyruese ku “detyrohet e paditura që paditëses t’i paguaj ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe trustit në mes të gradës 7 dhe 8, për çdo muaj duke filluar nga 01.02.2012, e në muajt në vazhdim sipas kontratës së punës me të cilën paditësja të e paditura ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar, me kamatë vonese prej 3.5%, duke filluar nga 01.02.2012, e deri në pagesën e plotë, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjyimit e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë”, pasi kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 pika n) të LPK-së, pasi vendosja si në dispozitiv të aktgjyimit të atakuar dhe arsyetimi i këtij aktgjykimi janë kundërtshëm në mes vete.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes si në dispozitivin e aktgjyimit të atakuar sa i përket pjesës detyruese, nuk ka përcaktuar vlerën monetare – dallimin në mes gradës 7 dhe 8, që duhet ti paguaj e paditura paditëses, ndonëse paditësi në padinë e parashtruar, në kërkesëpadi nuk ka caktuar shumat mujore si kërkesë e saj për pagesë, mos caktimi i shumave me të cilat detyrohet e paditura, për dallimin në mes gradës 7 dhe 8, aktgjykimin e bënë të pa qartë dhe si të tillë të pa përshtatshëm edhe për ekzekutim, që është edhe qëllimi i çdo aktgjykimi.

Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se dispozitivi i aktgjyimit me të cilin vendoset për kërkesën për pagesën e të ardhurave personale, duhet të përfshijë shumat dhe periudhën për të cilën është aprovuar apo refuzuar kërkesa.

Gjykata e Apelit sa i përket vendosjes si në pikën II. të këtij aktgjykimi, me të cilën është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog C.nr.105/012 i datës 20.09.2013, në pikën I. të dispozitivit “në pjesën me të cilën është provuar kërkesëpadi e paditëses dhe është anuluar aktvendimi i të paditurës Postës dhe Telekomunikacioni i Kosovës nr.01-1040-12393/2012, i datës 07.03.2012”, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike, në këtë pjesë aktgjykimi nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat është thirrur pala e paditur si dhe në dispozitat neni 182 par. 2, pika b), g), k) dhe m) të LPK-së dhe nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare. Gjykata e shkallës së parë me rastin e anulimit të aktvendimit të paditurës Postës dhe Telekomunikacioni i Kosovës nr. 01-1040-12393/2012, të datës 07.03.2012, drejtë ka zbatuar ligjin material dispozitat e nenit 11 të Ligjit të Punës.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar me të cilin vendim paditësit i është ulur grada e të ardhurave personale nga grada 8 në gradën 7, konsideron se Gjykata e shkallës së parë vendimin e saj për të anuluar aktvendimin mbi caktimin e lartësisë së të

ardhurave personale nr. 01-1040-12393/2012, i datës 07.03.2012, të nxjerrë nga Kryeshefi Ekzekutiv i PTK Sh.A., është bazuar dhe ka mbështetje ligjore në bazë të neneve 10 par. 1 dhe 2, pika 2.1, nenit 11 dhe 55 par. 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, lidhur me nenin 5 të kontratës së punës e lidhur me datë 24.10.2011.

Gjykata e Apelit vlerëson se vendimi i tillë ishte në kundërshtim me dispozitat ligjore – neni 55 par. 1, të Ligjit të Punës ku parashihet “i punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me kontratën e punës, në pajtim me këtë ligj, kontratën kolektive, aktin e brendshëm të punëdhënësit” dhe në kundërshtim me nenin 5 të kontratës së punës nr.01-2880-1331/2011 të datës 20.10.2011, shprehimisht është paraparë se “të punësuarit i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin në lartësi të gradës 8, sipas vendimit të bordit të përkohshëm të drejtorëve të PTK nr. 01-1630/05 datës 28.02.2005, së paku një herë në muaj e cila nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale”.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjendja faktike e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, sa i përket vendimit për anulimin e vendimit, duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë dhe se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar sa i përket anulimit të aktvendimit mbi caktimin e lartësisë së të ardhurave personale nr. 01-1040-12393/2012, i datës 07.03.2012, sepse paditësi dhe e paditura raportet e tyre, të drejtat dhe detyrimet e tyre punëdhënës-punëmarrës i kanë rregulluar me kontratë të shkruar, duke përcaktuar saktë të drejtat dhe detyrat e tyre reciproke, në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të Ligjit të Punës, se kushtet e kontratës së punës janë lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës duke marr për bazë edhe lartësia e pagës – përkatësisht gradës së të ardhurave personale sipas së cilës do të paguhet paga e punëtorit për punën e kryer.

Në rastin konkret Gjykata e Apelit konstaton se kontrata e punës e lidhur në mes paditësit dhe të paditurës ka mundur të ndryshohet vetëm me vullnetin e shprehur të të dyja palëve, dhe se e paditura nuk ka mundur të ndryshoj kushtet e kontratës vetëm me shprehjen e një anshme të vullnetit të saj dhe se aktvendimi për ndryshimin e lartësisë së gradës, duke e zvogëluar gradën e pagës bazë, siç e ka bërë e paditura, është i pa drejtë në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të Ligjit të Punës dhe në kundërshtim të plotë me nenin 5 të kontratës së punës dhe se një aktvendim i tillë nuk mund të pranohet si pjesë e kontratës së punës, gjersa të dyja palët nuk pajtohen për ndryshimin e kushteve të kontratës, e cila duhet apo është dashur të bëhet me aneks - kontratë, apo kontratë të re e jo siç ka bërë e paditura me aktvendim me shprehje të njëanshme të vullnetit. Pretendimi i të paditurës në bazë të nenit 5 të kontratës së punës aktvendimi për uljen e gradës është i ligjshëm, është i pa bazë, pasi në bazë të këtij neni (neni 5 i kontratës së punës) punëdhënësi ka ruajtur të drejtën e caktimit të vlerës së gradës (koeficientit), por jo edhe uljen e gradave, pasi e njëjta është caktuar që më parë me kontratën e punës.

Gjykata e Apelit sa i përket pretendimit të paditurës se ka qenë e detyruar të veproj në bazë të vendimit të dt. 06.12.2011 të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në bazë të cilit ka konstatuar se kërkesa e aksionarit Qeveria e R. Kosovës-Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka qenë ulja e shpenzimeve operative për personelin e të paditurës në raport me të hyrat e përgjithshme të PTK-së për vitin 2012, e cila duhet të jetë jo më shumë se 20%, e cila kërkesë nuk ka qenë kërkesë e uljes

së gradës së të ardhurave personale dhe si e tillë nuk ka mundur që të bëhet në mënyrë të njëanshme, siç e ka bërë e paditura në rastin konkret çka edhe vendimi i kontestuar është i padrejtë dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata e Apelit vlerëson se është i pa bazuar pretendimi i të paditurës se gjykata e shkallës së parë Aktgjykimin e ka nxjerrë me shkelje të nenit 401 të LPK-së, pasi nga procesverbali mbi mbajtjen e seancës së shqyrtimit kryesor, vërtetohet se nuk ka pasur as vërejtje për mbajtjen e seancës dhe as kërkesë nga palët që seanca e shqyrtimit kryesor të shtyhet për ndonjë arsye dhe me këtë nuk ka ndonjë shkelje që do të ndikonte në ligjshmërinë e vendimit të atakuar. Gjykata e shkallës së parë konform nenit 401 të LPK i është lënë mundësia e vlerësimit nëse duhet të caktoj seancën përgatitore duke marr për bazë ndërlikueshmërinë e rastit, andaj është çështje e vlerësimit diskrecial të gjykatës në të cilën palët kanë mundur të kenë vërejtjet e tyre gjatë seancës.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim pas administrimit të provave dhe vlerësimit të pretendimeve të palëve në procedurë, duhet të vendos në atë mënyrë që dispozitivi të jetë i qartë dhe të përmbaj kërkesën e palës paditëse. Për këtë arsye duhet që të kërkohet nga pala paditëse që lidhur me pjesën e dytë të kërkesëpadisë ta plotësoj të njëjtën duke përfshirë edhe vlerat monetare si dhe periudhën për të cilën është kërkuar pagesa e të ardhurave personale.

Meqenëse pika II. e dispozitivit nuk ishte objekt i pretendimeve ankimore, aktgjykimi i atakuar me ankesë në këtë pjesë, nga ana e gjykatës së shkallës së dytë ka mbetur i pa shqyrtuar.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika c) dhe d) të LPK, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr. 3089/13, me dt. 27.04.2016

Kryetari i kolegjit-gjykatësi,
Mr.sc. Rafet Haxhaj